

LUAN REXHEPI

8SH - 1

R 69



Kryet lart,  
Shqipëria

POEMË ime!

891983 = 1

R.62

15

LUAN REXHEPI

KRYET LART,

SHQIPËRIA IME!


40038

(POEMË PËR TRE HERONJTË E SHKODRËS)

30146

SHKODRË  
BIBLIOTEKA E SHTËTIT  
SHKODRË

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»  
TIRANË, 1966



O ç'm kujtim një melodit  
Shpesh krijshnikja Shpesh  
-Ti ke pas kenë një zotij e tashë-  
Shpesh

I

Agimi,  
Shpesh  
Me tufat e rrezeve  
Përhap midis njerëzve  
Dritë, qe e taton e notat e  
Ngrohtësi,  
Buzëqeshje.  
Por qëllon që ai  
Vjen me stuhi  
Dhe ahere  
Njeriu,  
Që prehet  
Në qoshen e tij,



S'mund të rrijë më

I strukur,

Në heshtje...

E sot?

Ç'paralajmëron sot

Kjo trokitje në portë.

Ky zë i herët,

Që po zgjon Shkodrën

Tej'e mb'anë?

Stuhi!

O, ç'mu kujtua një melodi!

Shqipëri, kreshnikja Shqipëri,

«Ti ke pas kenë një zonjë e randë»!.. 1)

Stuhi!

Po,

Shqiptari

E dallon mirë

Trokitjen e mikut

Nga ajo e armikut.

Ato janë dy notat e para,

Që stërgjyshët tanë

Në fillim të pentagramit

I kanë radhitur!..

Ahere, dil, armik,

---

1) Varg nga vjersha e Vaso Pashës «Mori Shqypni, e mjera Shqypni...»

Kushdo qofsh,  
Dil, i pabesë,  
Që ke ardhur  
T'i shkelësh shqiptarit  
Tinëzisht  
Në derë.  
Në këmbë, vëllezër!  
(Vargu im, rreshtohu dhe ti!)  
Shtëpi shqiptare!  
Sipas zakonit të vjetër,  
Përballë armikut  
Ngrihu kështjellë! .



## II

Përshëndete, njeri,  
Qytetin ku ke lindur,  
Ngope shikimin  
Me rrugët,  
Shtëpitë,  
Me kalanë e moçmë.  
Kush e di  
Ç'sjell kjo stuhi,  
Kush e di  
A do t'i shohësh më  
Pas ditës së sotme!..  
Përqafoje, bir,



Nënë që të lindi, <sup>2)</sup>  
Përqafoje  
Ajkunë<sup>3)</sup> e dhëmbshur shqiptare.  
O, Ajkunë, Ajkunë,  
Krijes' e pagjumë,  
Që as në legjenda  
S'e mbylle syrin  
Por si një statuj' e përjetshme,  
Gjithmonë qëndrove  
Krenare  
Mbi kryet e djalit të vvarë...  
Dhe motrën,  
Përqafoje motrën,  
Shtojzavallen besnike,  
Që plagët  
Gjith jetën  
Me shamin' e saj  
T'i ka lidhur. <sup>4)</sup>

---

2) Tre heronjtë para se të zinin pozicionet e luftimit, u përqaftuan me nënën dhe motrën e Jordanit, në shtëpinë e të cilit ndodheshin ditën e 22 qershorit 1942.

3) Ajkunë — emër i marrë nga cikli i kreshnikëve «Ajkuna kjan Omerin».


4) Motra e Jordanit i kish lidhur disa herë plagën Perlatit, që ish plagosur pak ditë para epopesë.

Zemër!  
Për njerzit e tu,  
Për jetën,  
Për lirin' e grabitur,  
Mes plumbave —

hidhur


- 2) Tre heronjtë para se të zinin pozitën e  
luftimit u përpuluan me gjëra dhe motrën e Jor-  
danit, në shprehje të cillit ndodhesha ditën e 22  
qershorit 1942.
- 3) Ajkunë — emër i murit nga cili i kresh-  
nikëve - Ajkunë kjan Omerit.
- 4) Mota e Jorbanit i krah hidhur dhe herë  
përsëri për të jeh-pasqur pak ditë para  
epopeës.





### III

Në pozicione!  
Përpara,  
Në sulm  
Njeri pas tjetrit, mendime!..  
Ngri flamurin, i pari:  
«Kjo shtëpi  
Është barikadë  
E ngritur  
Nga dora  
E Partisë Komuniste time»  
Përpara!  
A e dëgjoni?



Shpallet  
Mobilizim  
I përgjithshëm  
Për ju:  
Pushkë,  
Revole,  
Bomba dore...  
Jordan — dil këtu!  
Branko — dritaren!  
Perlat — përgjo koridorin!  
Sy nierëzorë!  
Erdh' radha juaj  
Ju, ndoshta,  
Do të kishit dëshirë  
Të shetitnit lëndinave  
Ose të humbisnit  
Mes valëve t' Adriatikut  
Pas një barke...  
Por, sot, sy,  
Ju kini  
Një detyrë të rëndë,  
Një detyrë  
Thjesht ushtarake...  
Hidhni pra,  
Prozhektorët tuaj  
Tej,  
Në frontin e armikut.

«Ne jemi të rrethuar,  
Dhe sigurisht,  
Do të përpiqemi  
Ta çajmë  
Rrethimin e papritur.»  
Por — dëshirë!  
Merr  
Nga skuadra zbuluese e syve  
Të dhënat e fundme:  
«Këtu  
S'ka asnjë mundësi dalje.  
Janë qindra.  
Këtu  
E vetmja liri e mundëshme  
Është  
Liria e pakufishme e depërtimit  
të plumbave!..»  
Plumb!  
Shpend i lirë, pullumb!  
E shoh  
Se s'të pritet  
Të dalësh  
Sa më shpejt  
Në liri...  
Por, prit, plumb,  
Këtu është luftë,  
Dhe,



Të takojnë  
Detyra ushtarake  
Dhe ty...  
Ja, çohu, Perlat,  
Jepi detyrën  
Plumbit të parë:  
«Objektivi —  
Mareshali fashist  
Në krahun e djathtë  
100 metra larg.  
Në ballë!»  
Gati edhe një skuadër tjetër!  
Të gjithë  
Me një vrap,  
Flakë!  
Batare!  
Detyra:  
Njoftoni armikun,  
Se shtëpia s'dorëzohet.  
Komandant i përgjithshëm —

Gjenerali ATDHE!..



#### IV

Atdhe!  
Paraqitet  
Me raport — rrufe  
Njësi komunist  
I përbërë  
Prej tre vetësh:  
«Përveç të vrarëve  
Dhe të plagosurve,  
I kapëm rob armikut  
Edhe agjentin e tij të vjetër — Vdekjen.  
Por, prit pak, Atdhe!

Vdekjen  
E kemi shkelur me këmbë,  
S'ngrihet më dot.  
Po e ndërpresim  
Përkohësisht  
Raportin.  
Një bandë e zezë plumbash  
Po na fluturon  
Mbi kokë...  
Tfu, djajt' e mallkuar!  
Përgjysëm  
Bisedën  
Na e lanë...  
Po, Atdhe,  
Gjëndja  
Po vështirësohet:  
Flakë,  
Tym,  
Copra,  
Breshëri  
Nga çdo anë...»  
Pra, ngjish radhët, treshe!  
Një mbledhje,  
Një raport,  
Një vendim të shpejtë,  
Luftarak:  
«Urdhër dite —




Komunisti Branko Kadija

Ngarkohet

Të çajë

I pari rrethimin

Nëpër flakë!...»



Do ndizet  
Ky prag  
Plumbat  
Ngarkohet  
Me krahët dhe zjar  
Do ndizet ky prag  
Me krijes  
Dhe zjar  
Do ndizet hapësir  
Në vallet tënde behtim sot, Liri  
Vallet shpirtore  
Me krijes  
Të shënës,  
Dollit!  
Le ta njohë këtë valle  
Mik e armik  
Eja shkodër  
Karru me ne



V

«Me krisma dhe zjarr  
Do ndizet ky prag.  
Me krisma  
Dhe zjarr.  
Do ndizet hapsira...  
Ne vallen tënde hedhim sot, Liri,  
Vallen shqiptare  
Me klithma,  
Të shtëna,  
Dollira!..  
Le ta njohë këtë valle  
Mik e armik.  
Eja, Shkodër,  
Kapu me ne

Dorë për dore!  
Nise vallen, Branko:  
— Shporruni këndeja  
Kafkëngrënës,  
Shëmtira,  
Ulokë,  
Të mbledhur  
Nga «Ferri» i Komedisë Hyjnore!..  
Me krisma  
Dhe zjarr  
Do ndizet  
Ky prag.  
Plumba!  
Ngarkoni shpinën  
Me barra të reja,  
Detyra:  
«Vdekje fashizmit!  
Liri popullit!  
Të fala nënave nëpër shtëpira!..»  
Si erë vërshëlle,  
Rrotullohu si tufan  
E rrepta e Lirisë valle,  
(Dhe ti, vargu im,  
Me krisma dhe zjarr  
Zëvendësoje  
Muzikën funerale!..)  
Por, dale...

40028  
30146  
MATEKA & SHITEJ  
BIBLIOTEKË



Brankua po ngrihet,  
Me gjoksin të shpuar  
Po turret përsëri  
Me plumba,  
Me bomba,  
Kushtrime:  
«Ndal, armik!  
Kryet lart, Shqipëri!  
Kryet lart, e dashura Shqipëria ime!»



#### VI

Me krisma dhe zjarr  
Do ndizet ky prag.  
Me krisma dhe zjarr  
Do ndizet  
Kjo shtëpi,  
Kjo tokë,  
(Dhe vargu im në këtë poemë...)  
Nuk e dimë  
A është zjarri,  
Që e krijoi gjithësinë,  
Por dimë:  
Përmes zjarresh  
E ngritëm atdhenë.

Dhe s'pritëm për këtë Promethenë...

Jo,

Zjarrin

E krijuam vetë,

Duke fërkuar

Shpirtrat tanë,

Siç fërkonin

Njerëzit e vjetër

Dy copra drurë

Në lashtësi,

I fërkuam

Dhe nxorëm

Më të fuqishmin zjarr,

Zjarrin e pashuar

Me emrin «PARTI».

Ne jemi shkëndija të tij.

Shkëndija — njerëz,

Që jetojmë

Me ajër,

Me dritë,

Me ujë...

Përpara, Jordan,

Ta mbytim njëherë flakën<sup>5)</sup>

---

5) Jordani, i përzhitur nga flakët, hidhet në pus për të shuar plagët, ku kapet dhe pas disa javësh jeton të dytën vdekje heroike i varur në litar, pa u dorëzuar shpirtërisht!



Dhe ta ndezim më fort,  
Siç e ndezi Skënderbeu  
Kur u kthye në Krujë! .  
(Vargu im, mos u nxit as për vaj, as  
për kujë).

Merr hua nga koha  
Disa javë  
Dhe na drejto atje  
Ku trekëmbëshi  
Kërcet dhëmbët  
Që një fjalë,  
Një besë,  
Një ideal  
Të përkulë: **IIV**

«Vampirë të pangopur!  
Ju mund të kaloni  
Përmes trupit të një komunisti,  
Por, përmes shpirtit —

«kurrë!»



## VII

Me krisma dhe zjarr  
Do ndizet ky prag.  
Plumba!  
Rrotullohuni  
Me tërbim  
Në karikatoren e zemrës:  
«Të parin — për Brankon!  
Të dytin — për Jordanin!  
Të tretin — për bekimin e nënës!..»  
Por, fundi,  
Jua besoj juve komandën...  
Bomba!  
Këtu

S'ka dallim më  
Kush është komandanti  
E kush ushtria...  
Luftëtarë të hekurt!  
Shokë të mi!  
Unë e di:  
Ashtu si mua  
Edhe juve  
Ju djeg urrejtja dhe dashuria.  
Depërtoni ku të mundni,  
Në çdo të çarë,  
Djathtas,  
Majtas,  
Përpara,  
Prapa,  
Se trarët po shëmben,  
Se qjelli po skuqet,  
Se në shtëpi,  
Në çdo anë  
Ka nxjerrë kthetrat flaka.  
Po,  
Ajë është.  
E njoh mirë  
Fytyrën e saj  
Të plasaritur  
Me rrudha të kuqe.  
Si u gënjeve, flakë?  
Si e pranove



Ta nxish  
Fytyrën tënde  
Me turpe?!.  
Të shtynë?  
Të shtynë!  
Dor' e huaj ishte  
Apo dorë shqiptare?  
Tfu, tradhëti!  
E mësuar  
Të mahesh si krimb  
Mbi varre,  
Kokalla,  
Gërmadha!  
Ule kokën, flakë!  
Kam dhe dy plumba:  
Një për veten  
Dhe një për spiunin  
Që ti fsheh prapa krahëve...  
Dorën drejt, Perlat!  
Detyra është e rëndë:  
Godit tradhëtinë  
Në emër të të gjithë shqiptarëve!..  
Kam dhe një bombë:  
Bombë të kuqe,  
Bombë të zjarrtë,  
Bombë të madhe...  
Kjo është zemra ime,  
Që do ta shkul nga gjoksi

Dhe do ta hedh  
Në emër  
Të Partisë Komuniste Shqiptare.  
Për të do të brohoras;  
Me zërin e saj  
Do ta bashkoj zërin tim  
Gjer në të fundit frymëmarrje.  
Një minutë, plumb' i fundit! 7)  
Plumbi im i ngadhnjimit!  
Brohori! —  
Parakalon

LUFTA NACIONAL ÇLIRIMTARE!..

Redaktor: Kujtim Zhejli  
Korrespondent: Nela Turkuçi  
Fotograf: Petri Mami  
Redaktor: Nela Turkuçi

---

7) Perlati i djegur këmbë e kokë nga flakët,  
vret veten, për të mos iu dorëzuar armikut.

Redaktor: Adelina Mamaqi  
Korektor letrar: Neka Turkeshi  
Piktor: Pandi Mele  
Redaktor teknik: Adem Lita

Tirazhi 6000 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-65

---

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë, 1967